




SHPREHIM IDETË



UNË DEMOKRACIA

ILIR (13), BLERIM (14), ALMIR (14), JONA (14), ILMIR (13), ANESA (13), FRANQESK (14), LEONARD (13),
ADEA (13)



Të mbështetemi tek njëri-tjetri, sepse duke bashkëpunuar, arrijmë te lumturia e secilit prej neve

Kur dëgjojmë fjalën demokraci, fjalët e para që na bien ndër mend janë: liria, të drejta e njeriut dhe barazia. Sot, demokracia neve na mundëson të drejtën e shkollimit, të drejtën e lojës, të drejtën e të shprehurit lirshëm, etj. Mirëpo, Kosova, shteti ynë nuk i ndalon asnjëherë përpjekjet për përmirësimin e demokracisë. Pasi që zgjedhjet janë elementi bazë në demokraci, ne kemi mundësinë e zgjedhjes në fusha të ndryshme. Për shembull, sot gjatë punës sonë grupore, i kemi ndarë rolet, duke marrë për bazë preferencat e secilit. Disa kanë vizatuar, disa kanë shkruar në laptop, disa kanë dhënë ide se si të shkruhet artikulli, etj.

Të drejtat që i përmendëm më lart janë të garantuara me ligj. Shpesh na duket se ligjet na kufizojnë neve, por jo. Ato përkundrazi garantojnë të drejtat dhe liritë tonë. Ligjet thjesht na ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Normalisht ligjet formohen diku dhe nga dikush. I gjithë ky proces fillon me qytetarët. Ata i zgjedhin përfaqësuesit e tyre (deputetët), kurse deputetët zgjedhin kabinetin qeveritar. Me propozimet e këtij kabineti, deputetët në Kuvend miratojnë ligjet në të mirën e popullit.

Vlen të përmendet edhe një shembull, ku ne si fëmijë

jemi ndër të barabartë. Në Punëtorinë e sotme, ku ne patëm mundësi të jemi në rolin e gazetarëve, kemi genë të ulur në një tavolinë rrethore. Po të ishim në një tavolinë drejtkëndore, dikush ndoshta do të ndihej më i privilegjuar se dikush tjetër.


Ky ishte vetëm një krahasim me ndjenjën e barazisë që na jep demokracia në vendin tonë.



Ne jemi e ardhmja

MEDIA DIKUR DHE MEDIA SOT

DION (13), DRITON (13), ENEA (13), JON (13), ELSA (14), VALDRIN (14), VESA (14), PLATOR (13),
ERJON (13)



Shtypshkronja e parë elektronike

Ditët e sotme, komunikimi me shokët e shoqet, marrja e informatave, hulumtimi për gjërat që na interesojnë, janë bërë shumë më të lehta sesa vite më parë

Le të kthehemi në kohë, në 5 vjetët e para të shkollës fillore. Atë kohë, ne ishim akoma me mësuesen tonë të dashur, me të cilën kaluam momente të bukura. Në rregulloren e shkollës sonë, ishin të parapara 4 mbledhje kryesore. Por, mësuesja jonë ishte shumë e përgjegjshme dhe kishte raste kur ajo organizonte edhe mbledhje të tjera. Mënyra se si ajo kontaktonte me prindërit tanë ishte me anë të një zarfi, në të cilin ajo u jepte të gjithat informatat rreth mbledhjes. Ai zarf u përcillej të gjithë prindërve, përmes nesh. Brenda atij zarfi, në anën e prapme, prindërit jepnin konfirmimin e tyre nëse do të mund të marrin pjesë në mbledhje apo jo, ose shënonin ndonjë koment tjetër. Kjo ishte mënyra e komunikimit ndërmjet mësueses dhe prindërve tanë. Ndërsa, në ditët e sotme, komunikimi mësimdhënës-prindër bëhet përmes një grupi në rrjetin social „Viber“. Gjithashtu, ne nxënësit komunikojmë me mësimdhënësit tanë me anë të email-it. Përmes tij, ne i dërgojmë detyrat e shtëpisë, punimet e ndryshme, ose në rast se ne kemi ndonjë kërkesë gjatë pushimit i drejtohem kujdestares sonë. Gjithë këto mjete me të cilat ne informohemi, qoftë në shkollë, qoftë në vende të tjera, quhen media. Media është një formë informimi që neve na mban të


informuar me anë të televizorit, telefonit, radios, librave, revistave, etj. Këto media ndahen në dy grupe: në të shkruara dhe elektronike.

Në media të shkruara, ndër shumë të tjerash, hyjnë edhe ato që përdorte mësuesja për t'i informuar prindërit tanë, pra, me anë të zarfit. Ndërsa, media elektronike janë ato të cilat i përdorim sot, pra emaili, telefoni, etj.


Të dashur lexues, qëllimi i këtij artikulli është që t'iu këshillojmë juve që ta kurseni kohën tuaj dhe të përdorni median elektronike. Ajo jo vetëm që është më e shpejtë, por edhe është një burim shumë i gjerë i informatave. Gjithashtu, përmes saj ju mund të mësoni më shumë për demokracinë kosovare. Shpresoj se po kënaqeni duke e lexuar punimin tonë.



Përfaqësuesit e informimit elektronik



Demokracia na jep liri, në të gjitha fushat e jetës. Ne jemi të lirë të komunikojmë dhe të shprehim mendimet tona. Si dhe, jemi të lirë të zgjedhim profesionin që na pëlqen



Qytetarët aktiv janë kudo. Ata përpiqen t'iu ndihmojnë të tjerëve dhe të ngrisin vetëdijen shoqërore mbi demokracinë. Për ta arritur këtë, mund ta përdorim edhe median



U gëzuam që patëm mundësinë të mësojmë për Kuvendin, që e pamë nga afër dhe që ishim pjesë e këtij institucioni

QYTETARËT AKTIV NË DEMOKRACI


ELSA (14), JETMIRA (13), GETOAR (14), DIOR (14), LORIK (13), TRIUMF (13), EROLL (14), BELINDA (13),

RREZE (14)



Ka shumë mënyra se si mund të ndikojmë në vendin tonë dhe ta ndryshojmë atë për mirë. Disa nga këta shembuj i kemi paraqitur më poshtë. Do të na lumturoni pa masë, nëse e lexoni artikullin tonë

Shkolla jonë „Fehmi Agani“ ka plot nxënës aktiv. Ata bëjnë punë vullnetare dhe iu ndihmojnë familjeve në



nevojë. Të gjitha klasat e shkollës sonë bashkohen dhe ndërmarrim iniciativë mbledhjen e ushqimeve. Më pas, drejtoresha e shkollës sonë, bashkë me disa nxënës këto ushqime ua dërgojnë familjeve, të cilat kanë nevojë për ndihmën tonë.

Përveç shkollës sonë, ka edhe shumë shkolla të tjera, me të cilat mblidhemi dhe mundohemi që sado pak ta pastrojmë ambientin në disa vende të qytetit tonë. Po ashtu, në Prishtinë është edhe e quajtura „Shtëpia e Plegqe“.

Në këtë institucion jetojnë persona të moshuar, larg familjeve të tyre. Ne kemi dëgjuar në lajme se ky institucion ka shumë probleme.

Andaj, ne si të rinj mund të bëjmë shumë për këta qytetarë. Ne mund të shkojmë të kalojmë kohë me ta. Mund t'iu ndihmojmë me ilaçet e tyre dhe të kujdesemi për nevojat që kanë. Ky gjest kaq i vogël për ne, nënkupton shumë për të moshuarit.

Aktiv mund të jemi edhe kur marrim pjesë në zgjedhje, apo edhe kur marrim pjesë në tubime publike. Në qoftë se një qytetar ndihmon shtetin e vet, ai është një qytetar i përkushtuar dhe punon për çdo të mirë të tij. Kjo quhet qytetari aktive. Gjithçka që ne bëjmë për të ndihmuar vendin tonë dhe qytetarët e vendit tonë, na bën neve qytetarë aktiv. Prandaj, të bëhemi të gjithë aktiv. Faleminderit që ndatë kohën tuaj për këtë artikull.



Ne, gazetarët e përkushtuar të demokracisë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë